



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Nr: 03-111/01-5202
Datë: 25.01/2023



KOMUNA LIPJAN
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE-
QENDRA KRYESORE E MJEKSISË FAMILJARE

Bazuar ne nenin 78,80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarë Publik nr. 06/L-197, neni 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-121, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 49 pika 49.2 të Statutit të Komunës së Lipjanit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të punës

Dy (2) Mjek të Stomatologjisë një (1) në QMF-Shalë dhe një (1) QMF-Janjev

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mjek të Stomatologjisë:

1. Planifikon sasinë dhe llojet e materialit stomatologjik për vitin pasardhës, dhe shtimin e gamës së punëve stomatologjike dhe respekton orarin e punës.
2. Është e ndaluar shfrytëzimi i funksionit dhe postin e tij për të rritur klientelën në sektorin privat për përfitime të tjera personale të kundërligjshme dhe është përgjegjës për raportime mujore dhe njoftime për mungesën e materialit të domosdoshëm për profesionin e tij.
3. Pavarësisht profilit detyrimi i tij për respektimin dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit të Shëndetësisë Statutit të Komunës, statutit të QKMF-se dhe akteve tjera nënligjore të institucionit si dhe respektimin e pavarësisë profesionale të secilit, në interes të sëmurëve dhe ruajtjes së emrit të mirë të profesionit dhe të institucionit mjekësor.
4. Harton planin vjetor për terapinë, mjetet dhe instrumentet për organizimin e punës në ordinancën ku punon.
5. Është detyrë të merr pjesë në mbledhjet të cilat i fton Drejtori e në të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative në nivel të QKMF-ës.
6. I përgjigjet situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në çdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente kurse me kërkesën e shefit të Stomatologjisë ose Drejtorit mund të sistemohet në ordinancat tjera të QKMF në QMF ose AMF aty ku ushtrohet profesioni i stomatologjisë.
7. Kryen edhe pune tjera me kërkesën e shefit të njësisë së stomatologjisë ose Drejtorit të QKMF-se për punën e tij i përgjigjet Shefit të sektorit të stomatologjisë-Drejtorit

Kushtet dhe kriteret për Mjek të Stomatologjisë:

- Fakulteti i Mjekësisë – Drejtimi i Stomatologjisë
- Licenca e Punës
- Certifikata Shëndetësore
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega në Lipjan
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi kopje.

Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të përshkruara më lartë
- Të ketë shkathtësi dhe kualitete personale.

Paga mujore për Mjek të Stomatologjis:

Grupi H klasa H10 **Koeficienti:7.4**

Kohëzgjatja e kontratës me kohë të pacaktuar

Puna Provuese gjashtë muaj (6)

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike, e drejta për aplikim nga data **25.01/2024** deri me **23.02/2024** që konsiderohet si dita e fundit e konkurrimit.

Paraqitja e Aplikacioneve:

Aplikacionet mundë të merren në mënyrë fizike në zyrën për shërbime me qytetarët në Komunën e Lipjanit sporteli nr. 3 dhe dorëzohen në të njëjtën sportel bashkë me dokumentet e kërkuar në konkurs.

Vërejtje:

Dokumentet e dorëzuara duhen të janë kopje të noterizuara (Diploma dhe Licenca) dhe ato nuk kthehen, ndërsa aplikacionet e pa kompletuara dhe pas afatit nuk do të shqyrtohen, **te gjitha njoftimet dhe rezultatet shpallen në ueb faqen e Komunës <https://kk.rks-gov.net/Lipjan> dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.**

Drejtori i DSHPS-së
Shkelzen Hajdini

